

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Do t'i biem pishmanit, por do jetë vonë", momenti kur Rexhep Selimi i lutej Jakup Krasniqit kundër Gjykatës Speciale (VIDEO) - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/do-ti-biem-pishmanit-por-do-jete-vone-momenti-kur-rexhep-selimi-i-lutej-jakup-krasniqit-kunder-gjykates-speciale/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 16:34:49 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 16:31:27 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ec0943c45600a4a19a31eadcd23366b8aebcaeede337397eec9bdfc019c6a301
TEKSTI	9233ad028bc1e686f01d5292b82df761497236117a934e3726d200f1053050c0
PAMJA	c1438330bbb275fac2145d777ef58968f6a88d454d8100d2adf95905b75b4887

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	25c4eaad73b560397e37b2edb746644e9d9c771125063991df79bb75937f86f0
E MËPARSHMJA	a15d4dfe1343f3c4b909e9f83552cf6123d1cdfdbef5fe0d69c3993b6bf888de
RRËNJA MERKLE	9515102868483048fab913125dfd13516db18986db3bd96a2369642ebf1c0d96
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/25c4eaad73b560397e37b2edb746644e9d9c771125063991df79bb75937f86f0>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

Gjyqi i UÇK Rexhep Selimi Mbretëri e Bashkuar Jakup Krasniqi Noah Woods

KOSOVË | LAJMI I FUNDIT

“Do t’i biem pishmanit, por do jetë vonë”, momenti kur Rexhep Selimi i lutej Jakup Krasniqit kundër Gjykatës Speciale (VIDEO)

LAJMI I FUNDIT

18:35 Bajraktari: Vendimi i Speciales skandaloz, skena politike në Kosovë të bëhet bashkë

18:31 Të dhënat e qindra klientëve të evropianë të një banke dixhitale bien në duart e hakerëve

18:15 Zhduket 3-vjeçari nga këndi i lojërave në Angli, mbi 1 000 persona mobilizohen në kërkime për gjetjen e tij

18:07 Planeti nën sulm nga dy stuhi diellore: Cilat zona do të preken?

SHPËRNDAJE

ARTIKULLIN

18:01 Shembet miniera e arit në Sudan, 82 të vdekur dhe 50 të plagosur

18:00 Plagosje me armë zjarri në Durrës

16 Shtator 2026 | 18:31

Një video e publikuar së fundmi rikthen në vëmendje qëndrimin e Rexhep Selimit në Kuvendin e Kosovës në vitin 2015, kur deputetët po shqyrtonin ndryshimet kushtetuese që i hapën rrugë themelimit të Gjykatës Speciale.

Në pamje, Selimi i drejtohej asokohe kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqit, duke i kërkuar që të mos lejonte votimin e rezolutës për themelimin e Gjykatës Speciale.

“Do t’i biem pishmanit, por do jetë vonë”, shprehej Selimi nga foltorja e Kuvendit.

“Kjo rezolutë është kundër interesave të qytetarëve të Kosovës. Kjo rezolutë është kundër Pavarësisë së Kosovës. Mos e lejoni. Sot është mëngjesi më i rëndësishëm për Kosovën, mos e lejoni, sepse edhe ju edhe ne do t’i biem pishmanit, por do jetë vonë”, deklaronte ai.

Pavarësisht kundërshtimeve dhe debateve të ashpra politike, më 3 gusht 2015 Kuvendi i Kosovës miratoi ndryshimet kushtetuese që i hapën rrugë themelimit të Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar. Amendamentet u miratuan me 82 vota pro, 5 kundër dhe një abstenim.

Votimi i asaj dite ishte një nga vendimet më të rëndësishme dhe më të debatuar të pasluftës në Kosovë. Institucioni i krijuar pas këtij procesi do të merrte vite më vonë në gjykim disa prej figurave kryesore të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Mes tyre ishte edhe vetë Rexhep Selimi, i cili u arrestua në nëntor 2020 dhe u transferua në Hagë së bashku me Hashim Thaçin, Kadri Veselin dhe Jakup Krasniqin.

TESTIM



Sot, më 16 shtator 2026, Gjykata Speciale shpalli aktgjykimin e shkallës së parë ndaj katër ish-krerëve të UÇK-së. Hashim Thaçi u dënua me 25 vjet burgim, Jakup Krasniqi me 25 vjet, Kadri Veseli me 18 vjet, ndërsa Rexhep Selimi me 13 vjet burgim. Dënimet përfshijnë edhe kohën e kaluar në paraburgim.

Në aktgjykim, trupi gjykes i gjeti të katër të akuzuarit penalisht përgjegjës për krime lufte që lidhen me ndalimin arbitrar të 385 personave, trajtimin mizor të 49 personave, torturën e 303 personave dhe vrasjen e 96 personave.

Ata u shpallën të pafajshëm për akuzat për krime kundër njerëzimit, pasi Prokuroria Speciale nuk arriti të provonte përtej dyshimit të arsyeshëm se kishte pasur një sulm të gjerë ose sistematik ndaj popullsisë civile.

Shiko në:

LAJME TË SUGJERUARA

KOSOVË

Bajraktari: Vendimi i Speciales skandaloz, skena politike në Kosovë të bëhet bashkë

Veprimtari shqiptaro-amerikan, Harry Bajraktari, e cilësoi si "skandaloz" vendimin e Gjykatës Speciale ndaj katërshe së UÇK-së, duke vlerësuar se sot është ditë "e trishtueshme për...

18:35 | 16/09/2026

KOSOVË

Serwer: Amerikanët dhe evropianët të ndihen të turpëruar, kanë kriminalizuar një lëvizje çlirimtare të cilën e mbështetën

Profesori amerikan dhe njohësi i çështjeve të Ballkanit, Daniel Serwer, ka reaguar pas aktgjykimit dënues që Gjykata Speciale dhe ndaj katër ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare...

17:44 | 16/09/2026

KOSOVË

Britania: Mbështesim fuqishëm Kosovën, jemi krenarë për ndërhyrjen e NATO-s më 1999

Mbretëria e Bashkuar e mbështet fuqishëm shtetin e Kosovës dhe ndihet krenare që me aleatët e NATO-s intervenoi më 1999, ka deklaruar ministri britanik për...

17:40 | 16/09/2026

TEMA

Vendi
Rajoni
Bota
Video

SHËRBIME

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara

KOMPANIA

Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontakttoni

Punësimi

Follow Euronews on all platforms:

Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.